

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PKL-KZZ-65/10
Data: 25 tetor 2011

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Martti Harsia si Kryetar i kolegjit, me Gjyqtaren e EULEX-it Anne Kerber dhe Gjyqtarët e Kosovës të Gjykatës Supreme të Kosovës, Erdogan Haxhibeqiri, Marije Ademi dhe Salih Toplica si anëtarë të kolegjit, në praninë e Adnan Isufit Këshilltarit Ligjor të EULEX-it, në cilësi të procesmbajtësit, në lëndën penale të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P nr 570/07 kundër të pandehurve:

BR

VA

VV

VS

Të akuzuar për vepra penale të rrëmbimit, në bashkëkryerje, në kundërshtim të Nenit 159, paragrafit 2 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës (*tash e tutje "KPK"*),

VA

NL

Duke vendosur mbi Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga avokati mbrojtës [redacted] në emër të të pandehurit [redacted] kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P nr 570/07 të datës 27 maj 2009, dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap 282/09, të datës 31 mars,

Në përputhje me Nenin 454 paragrafin 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (*tash e tutje "KPPK"*) pas seancës së këshillimit dhe votimit të mbajtur më 25 tetor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës lëshon këtë:

NL

AKTGJYKIM

VA

Për të refuzuar Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të datës 01 qershor 2010, të paraqitur nga avokati mbrojtës [redacted] në emër të të pandehurit [redacted] kundër Aktgjykimit

të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P nr 570/07 të datës 27 maj 2009, dhe kundër Aktgjyqimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap 282/09, të datës 31 mars, si të pabazuara dhe vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme në përputhje me Nenin 456 të KPPK-së.

ARSYETIM

I. Historia e Procedurës

1. Më 31 tetot 2007, prokurori Publik ngriti Aktakuzë kundër të akuzuarve [redacted] dhe një Propozim për dëmin kundër të miturit [redacted] duke i akuzuar ata të kenë kryer në bashkëkryerje, veprën penale të Rrëmbimit, në kundërshtim të Nenit 159 paragrafit 2, lidhur me Nenin 23 të KPK-së.

2. Prokuroria pretendoi se më 10 dhjetor 2005, rreth orës 00:30, në Prishtinë, në lagjen Dardania, të pandehurit, në bashkëkryerje, me qëllim dhe në përputhje me një marrëveshje paraprake, rrëmbyen viktimën [redacted] duke e fshehur atë në shtëpinë e [redacted] në Rrugën [redacted] në [redacted] derisa të pandehurit e liruan viktimën, vetëm me 13 dhjetor 2005 rreth orës 02:00, pasi babai i viktimës [redacted] kishte paguar, në një rrugë me zhavorr afër fshatit [redacted] haraçin prej 230.000,00 Eurosh.

3. Më 1 prill 2009, filloi shqyrtimi gjyqësor në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, në një seancë të mbyllur, pa praninë e publikut, në përputhje me Nenin 69 të Ligjit Penal për të Mitur të Kosovës (tash e tutje "LPMK").

4. Më 27 prill 2009, njëri nga të pandehurit, [redacted] nuk u paraqit para gjykatës dhe avokati i tij mbrojtës pohoi se klienti tij iu kishte nënshtuar një intervenimi kirurgjik në sy në Norvegji dhe se do të kthehej në Kosovë brenda dy apo tri javësh. Gjykata konsideroi se as avokati mbrojtës e as i pandehuri nuk kishin ofruar asnjë dokument mbështetës lidhur me ekzistimin e operimit urgjent mjekësor. Gjykata përfundoi se mungesa e të pandehurit [redacted] nuk ishte arsyetuar, prandaj ishte lëshuar një urdhër arrest për të pandehurin. Gjykata rrjedhimisht vendosi për ndarjen e procedurës dhe vazhdoi me procesin gjyqësor kundër të pandehurve të tjerë.

5. Më 27 maj 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë shpalli aktgjykimin. Të gjithë katër të pandehurit; [redacted] dhe [redacted] u shpallën fajtorë për kryerje të veprës penale, në bashkëkryerje, të Rrëmbimit, në kundërshtim të Nenit 159 paragrafit 2 lidhur me Nenin 23 të KPK-së.

6. Kundër Aktgjyqimit të lëshuar në shkallë të parë janë ushtruar ankesa nga Prokurori Publik dhe avokatët mbrojtës; Av. [redacted] në emër të të pandehurit [redacted] Av. [redacted] në emër të të pandehurit [redacted] dhe Av. [redacted] në emër të të pandehurit [redacted]

7. Më 31 mars 2010, Gjykata Supreme e Kosovës refuzoi të gjitha ankesat e ushtruara nga avokatët mbrojtës si të pabazuara. Ankesa e prokurorit publik u pranua pjesërisht sa i përket kohëzgjatjes së dënimit.

8. Më 1 qershor 2010, avokati mbrojtës Av [redacted] në emër të të pandehurit [redacted] paraqiti një Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P nr 570/07 të datës 27 maj 2009, dhe kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap-Kz 282/09, të datës 31 mars, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale.

9. Avokati mbrojtës kërkoi ndryshimin e aktgjykimeve të kundërshtuara; të lirohet i pandehuri nga kryerja e veprës penale të Rrëmbimit në bashkëkryerje me të akuzuarin [redacted] e të tjerët, ose të anulohen aktgjykimet e kundërshtuara dhe të kthehet lënda për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, ose të ndryshohen aktgjykimet e kundërshtuara përkitazi me cilësimin e veprës penale si Dhënia e Ndhmës Kryerësve pas Kryerje së Veprës Penale në përputhje me Nenin 305 dhe të shqiptohet një dënim më i butë kundër të pandehurit.

10. Me parashtresën KMLP. II. Nr 65/10 të datës 20 korrik 2010 Zyra e Prokurorit të Shtetit paraqiti një përgjigje dh propozoi që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar. ZPSHK-ja parashtroi se gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë kanë përshkruar veprimet e të pandehurit dhe drejt i kanë trajtuar këto si bashkëkryerje e jo sikur dhënie e ndihmës. Sipas vlerësimit të ZPSHK-së i pandehuri [redacted] kishte vendosur të bashkohet në bashkëkryerje të një veprë shumë të rëndë dhe më pastaj në bazë të marrëveshjes së tij kishte ndërmarrë ato veprime të përmendura në dispozitiv. Këto veprime nuk mund të konsiderohen si veprime të ndara por paraqesin një kontribut esencial për bashkëkryerje.

II. Gjetjet e Gjykatës Supreme

11. Në vlerësimin e Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës vërtetoi si në vijim:

a. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pranueshme. Kërkesa është paraqitur në gjykatën kompetente në përputhje me Nenin 453 par 1 dhe brenda afatit ligjor në përputhje me Nenin 452 par 3 të KPPK-së.

b. Gjykata Supreme e Kosovës vendosi në seancë siç parashihet me Nenin 454 paragrafin 1 të KPPK-së. Njoftimi i palëve lidhur me këtë seancë nuk ishte i nevojshëm.

c. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

12. Avokati mbrojtës pretendon në disa shkelje disa prej të cilave gjithashtu janë ngritur dhe dorëzuar gjatë procedurës në shkallën e dytë. Disa pjesë të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë kryesisht i referohen gjendjes faktike. Sidoqoftë, Gjykata Supreme e Kosovës është e kufizuar në vlerësimin e saj sipas nenit 451 dhe nenit 455 të KPPK-së. Avokati mbrojtës nuk

mund të paraqes kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbi bazën e vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike. Rrjedhimisht, kontestimi i gjendjes faktike në këtë fazë të procedurës është i papranueshëm.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të dokumentacionit gjen se aktgjykimet e ankimuarra të lëshuara në shkallët e mëparshme nuk e garantojnë intervenimin sipas detyrës zyrtare. Sipas nenit 455 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës do të kufizohet vetëm në shqyrtimin e këtyre shkelleve të ligjit për të cilat pala kërkuese pretendon në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë avokati mbrojtës pretendon si në vijim:

A. Shkelje ligjit penal (neni 404 paragrafi 1 pika 4) / neni 451 paragrafi (1) pika 1 e KPPK-së)

13. Avokati mbrojtës pretendon se dispozitat e nenit 23 në lidhje me nenin 159 paragrafin 2 të KPK-së në lidhje me nenin 404 paragrafin 1, pikën 4 të KPPK-së janë shkelur kur [REDAKTUAR] është cilësuar si bashkëkryerës edhe pse veprimet e vetme të tij janë përsëritur në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut (f. 17 versioni në gjuhën angleze) se ai *"..ka marrë [REDAKTUAR] nga vendi ku është pranuar haraçi.."* dhe se ai *"..gjithashtu ka mbajtur kontakte me një person të panjohur i cili ua ka huazuar armët e përdorura gjatë aktiviteteve kriminale"*. Gjendja faktike e vërtetuar nga Gjykatat nuk ia atribuon të dënuarit [REDAKTUAR] asnjë pjesëmarrje në kryerjen e veprës penale në fjalë e as në vendimin për kryerjen e rrëmbimit ose në përgatitjen e rrëmbimit ose pjesëmarrjen në cilëndo marrëveshje si anëtar i grupit për rrëmbim. Sipas avokatit mbrojtës, gjykatat gjithashtu nuk kanë interpretuar drejtë nenin 23 të KPK-së në lidhje me *"..thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër.."*. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se një pjesë e kësaj pyetje i referohet vërtetimit dhe përcaktimit të gjendjes faktike. Sidoqoftë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të paraqitet sipas dispozitave të KPPK-së.

Neni 451 (2) i KPPK-së përcakton:

(2) Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike...

Më tutje neni 456 i KPPK-së përcakton:

Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykim refuzon si të pabazë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kur vërtetohet se nuk ekziston shkelje e ligjit për të cilën pretendon paraqitësi i kërkesës, ose kur kërkesa është paraqitur për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike (nenet 405 dhe 451, paragrafi 2 i këtij Kodi).

Në bazë të arsyeve të lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se një pjesë e pyetjen në lidhje me gjendjen faktike është jashtë fushëveprimit të shqyrtimit në këtë fazë të procedurës, prandaj është e papranueshme.

Sa i përket nenit 23 të KPK-së *“gjykata ka dështuar që ta interpretoj, thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër.. “*, Gjykata Supreme e Kosovës do ta shtjellojë këtë çështje në pikat në vijim gjatë adresimit të pretendimeve të avokatit mbrojtës në lidhje me cilësimin e veprës penale.

14. Avokati mbrojtës pretendon në shkelje të nenit 458 të KPPK-së pasi që nuk ka pasur asnjë provë për të konstatuar siç ishte rasti në aktgjykimet e kundërshtuara se i dënuari ka qenë i përfshirë në ndonjë mënyrë, e lëre si anëtar i një grupi në kryerjen e veprës penale Rrëmbim, neni 159 paragrafi 2 i KPK-së. Prandaj, sipas avokatit mbrojtës Gjykata e Qarkut gabimisht ka konstatuar se veprimet e të pandehurit mund të cilësohen juridikisht si bashkëkryerje. Një interpretim i tillë paraqet një interpretim të zgjeruar të këtij koncepti ligjor. Kjo nuk është vetëm kundër teorisë së ligjit penal mirëpo gjithashtu edhe kundër praktikës gjyqësore në Kosovë dhe kudo. Avokati mbrojtës thotë se veprimi kriminal i Rrëmbimit përmbushet kur dikush rrëmbetet/kundërligjshëm privohet nga liria dhe mbahet për motivet e përshkruara në ligj.

Duke adresuar një pretendim të tillë Gjykata Supreme e Kosovës gjen se kjo pikë në masë të madhe ka të bëjë me vërtetimin e gjendjes faktike. Siç është cekur edhe më parë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të paraqitet mbi këtë bazë ligjore. Sipas dispozitave përkatëse të KPPK-së, Gjykata Supreme nuk është e obliguar që ta vlerësojë gjendjen faktike të vërtetuar në shkallën e mëparshme, përveç nëse ekzistojnë prova të reja të qarta të cilat nuk janë prezantuar, adresuar dhe administruar në shkallët e mëparshme të cilat tregojnë qartazi se vendimet e tilla janë marrë në mënyrë të padrejtë dhe të pasaktë. Sidoqoftë, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se avokati mbrojtës nuk i thekson apo argumenton ndonjë fakt të ri por ato që janë adresuar dhe trajtuar në mënyrë korrekte në shkallët e mëparshme. Prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se ky pretendim i avokatit mbrojtës është i pabazuar.

Sa i përket motiveve të mundshme të pandehurit, për të cilat mbrojtja pretendon se nuk janë vërtetuar, ky kolegji vëren se motivi i krimit nuk është pjesë e vetë krimit siç është përcaktuar me ligj. Motivët edhe pse janë të rëndësishme për vërtetimin e gjendjes faktike dhe për qëllimin e shqiptimit të masës kufizuese dhe kohëzgjatjes së dënimit, megjithatë ato nuk janë pjesë përbërëse e veprës penale. Nuk ekziston asnjë detyrim ligjor për gjykatën që të vërtetojë motivet të cilat e kanë shtyrë të pandehurin që të kryejë një vepër penale.

Në bazë të arsyeve të lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se në këtë pjesë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

15. Avokati mbrojtës pretendon se veprimi i ofrimit për ta çuar kryerësin te vendi ku është kryer krimi dhe kontaktimi me personin i cili ua ka huazuar armët kryerësve janë veprime tipike të dhënies së ndihmës kryerësve të veprës penale e cila është e definuar dhe e dënueshme sipas nenit 305 të KPK-së. Kjo pikë siç është cekur edhe më herët ka të bëjë me pretendimin e

VA

mëparshëm në të cilin avokati mbrojtës pohon se gjykatat më të ulëta nuk kanë ofruar arsye adekuate se si i pandehuri bashkërisht ka kryer veprën penale buke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thëlbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër. Sipas avokatit mbrojtës, veprimet e [REDACTED] nuk mund të bien nën dispozitat e nenit 23 të KPK-së pasi që ky nen kërkon të dy kushtet kryerjen e përbashkët të rrëmbimit si dhe të qenit të vetëdijshëm për bashkëpunimin e përbashkët, të cilin nuk e kemi në këtë rast. Sipas avokatit mbrojtës, më së shumti, [REDACTED] do të mund të shpallej fajtorë për Dhënie të ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprës penale sipas nenit 305 paragrafit 1 të KPK-së.

VA

Gjykata Supreme e Kosovës nuk pajtohet me avokatin mbrojtës se gjykatat e shkallëve të mëparshme kanë konstatuar gabimisht se i pandehuri në bashkëkryerje ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.

Gjatë shtjellimit të bashkëkryerjes, Gjykata Supreme e konsideron të rëndësishme që t'i referohet komentarit i cili edhe pse ka të bëjë me ligjin e mëparshëm të aplikueshëm në Kosovë, prapë mund të jetë i zbatueshëm për adresimin e kësaj çështje ligjore nga Kodi i tanishëm Penal i Kosovës pasi që nuk ka ndryshime esenciale përkritazi me konceptin e bashkëkryerjes. Komentari i referuar (neni 22 i Kodit Penal të Republikës Federative të Jugosllavisë, Ljubisa Lazarevic, 1995, botimi i 5-të) thotë:

"Bashkëkryerja (bashkëpunimi) është një akt me vetëdije dhe gatishmëri i lidhjes me anëtarë të tjerë me qëllim që së bashku të kryejnë një veprë të caktuar. Një situatë e tillë ekziston kur disa persona të cilët i përmbushin të gjitha kushtet që kanë të bëjnë me aktorin kryesor të një veprë të caktuar dhe së bashku pajtohen që të veprojnë si bashkëpjesëmarrës. Një bashkëpjesëmarrës është ai anëtar i cili së bashku me të tjerët, në bazë të roleve të ndara, vepron në drejtim të një veprë penale të caktuar dhe realizimit të saj mbi parimin e një qëllimi të përbashkët. Një bashkëpjesëmarrës është secili person i cili në bazë të marrëveshjes paraprake merr pjesë në ndarjen e roleve, të cilët së bashku lëvizin në drejtim të veprës penale të caktuar dhe rrjedhimisht e kryen pjesën e tij në procesin e kryerjes së një krimi; duke vepruar në këtë mënyrë, duke e kryer vetëm një segment i cili i është caktuar dhe të cilin e konsideron si të vetin dhe të grupit. Me çdo lloj aktiviteti një pjesëmarrës i vetëm bëhet bashkëpjesëmarrës, nëse vepra vjen si rezultat dhe brenda kornizës së performancës së ndërsjellë dhe të përbashkët, dhe nëse një pjesëmarrës i tillë shfaq gatishmëri për kryerjen e një veprë të caktuar".

BE

Në lëndën në fjalë, është e qartë se i pandehuri nuk ka qëlluar rastësisht në vendin ku është pranuar haraçi. Është e qartë se i pandehuri në pajtim me planin për të cilin janë pajtuar paraprakisht e ka marrë të pandehurin [REDACTED] nga vendi ku është pranuar haraçi. Kjo gjë është konstatuar saktë duke u mbështetur në provat të cilat janë siguruar dhe administruar në mënyrë korrekte gjatë gjykimit. Është e qartë se i pandehuri ka mbajtur kontakte me një person të panjohur i cili ua kishte huazuar armët e përdorura gjatë aktivitetit kriminal. Rolet e të pandehurit janë të kufizuara në performancën e aktiviteteve të ndara, të cilat në tërësinë e tyre i kontribuojnë përfundimit të suksesshëm të misionit; pikërisht bëhet fjalë për këtë lloj të ndarjes së aktiviteteve lidhur me kryerjen e kësaj veprë. Për këtë arsye, argumenti i mbrojtjes

se veprimet e të pandehurit në rastin më të keq do të mund të përbënin elemente të veprës penale të ofrimit të ndihmës kryerësit pas kryerjes së veprës penale është e pabazuar.

16. Avokati mbrojtës ka deklaruar se gjykata gabimisht ka marrë parasysh elementet e veprës penale ("... është ofruar të marrë [redacted] nga vendi i haraçit dhe të kontaktojë personin prej të cilit ata kishin huazuar armën.") po ashtu si elemente të cilat merren si rrethanë në pajtim me nenin 64 të KPK-së, gjatë vlerësimit të dënimit. (faqja 25 e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut). Sipas avokatit mbrojtës, cilësimi i gabueshëm juridik ka shpënë në këtë dënim jashtëzakonisht të lartë ndaj tij.

Gjykata Supreme e Kosovës nuk pajtohet me pikëpamjen e avokatit mbrojtës sa i përket kohëzgjatjes së dënimit. Ky krim është në veçanti i rëndë prandaj si i tillë kërkon dënim të rëndë. Duke marrë parasysh rrethanat të cilat lidhen me rastin, mënyrën si është kryer krimi – *modus operandi* si dhe shkallën e rrezikut social të veprës penale, kjo gjykatë konstaton se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, d.m.th. përputhet me qëllimin e dënimit, siç përcaktohet me ligj.

Për këtë arsye, Gjykata Supreme konstaton se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të plotë dhe të saktë ka shqyrtuar rrethanat relevante gjatë rritjes së kohëzgjatjes së dënimit.

B. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale (Neni 403, par. 1, pika 12)/ Neni 451, par. (1) pika 2) e KPPK-së)

17. Avokati mbrojtës pretendon se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është në kundërshtim me arsyetimin pasi që dispozitivi thotë se [redacted] së bashku me të pandehurin tjerë ka rrëmbyer viktimën "... në bazë të një marrëveshjeje paraprake..." përderisa në arsyetim theksohet se ai "... kishte vendosur t'u bashkohej bashkëkryerësve..."

Gjykata Supreme vlerëson se një pohim i tillë nuk ka baza. Asnjë kundërshti apo mospërputhje nuk është gjetur në dispozitivin e aktgjykimit ose në mes të dispozitivit dhe të arsyetimit. Vërtet, gjykata e shkallës së parë, në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar ka prezantuar faktet të cilat janë konstatuar dhe ka dhënë arsyet e veta të qarta dhe bindëse. Qëndron fakti se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë thekson se [redacted] së bashku me të pandehurit e tjerë ka rrëmbyer viktimën "... në bazë të një marrëveshjeje paraprake..." përderisa në arsyetim theksohet se ai "... kishte vendosur t'u bashkohej bashkëkryerësve..."

Megjithëkëtë, Gjykata Supreme konstaton se arsyetimi nuk është kontradiktore siç pohohet por i njëjti e plotëson dhe e sqaron dispozitivin. Arsyetimi i aktgjykimit nuk kundërshton dispozitivin por në të vërtetë ofron sqarime të mëtejshme pikërisht siç përcaktohet me dispozitat e procedurës penale. Duke shqyrtuar këtë pikë, Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka gjetur asnjë mungesë esenciale sa i përket dispozitivit të aktgjykimeve të apeluara. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në këtë rast, dispozitivët e aktgjykimeve të kundërshtuara janë mjaft të

qarta, përderisa në pjesën e arsyetimit, gjykata në mënyrë të hollësishme ka dhënë arsyet të cilat e kanë çuar këtë gjykatë në këtë përfundim.

Për këtë arsye, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se leximi i tërësishëm i aktgjykimit tregon se nuk ka mospërputhje apo kundërshti ndërmjet dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimeve të kundërshtuara.

Për këtë arsye, nuk ka bazë pretendimi i avokatit mbrojtës rreth mospërputhjes së aktgjykimeve.

18. Avokati mbrojtës pretendon se faktet vendimtare nuk janë prezantuar në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë ashtu si duhet gjatë konstatimit të ekzistimit të veprës penale dhe vlerësimit të dënimit. Në arsyetim veprimet e të pandehurit nganjëherë janë përshkruar si "... është ofruar të marrë [redacted] ..." ndërsa nganjëherë si "... ka marrë [redacted] ..", të cilat paraqesin dy veprime të ndryshme.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se avokati mbrojtës në mënyrë të gabuar u referohet dallimeve në pjesën e arsyetimit të aktgjykimeve të kundërshtuara. Vlen të përmendet se aktgjykimi është një dokument uniform i përbërë nga pjesët të cilat parashihen me ligj, prandaj si i tillë aktgjykimi duhet të lexohet në tërësi si një dokument i vetëm. Dispozitivi dhe arsyetimi janë pjesë organike dhe të pandara të aktgjykimit prandaj aktgjykimi duhet patjetër që të lexohet në kontekstin e tërësishëm. Leximi selektiv i aktgjykimit dhe nxjerrja e fjalive jashtë kontekstit të përgjithshëm e bën argumentin të paqëndrueshëm. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se aktgjykimet e nxjerra në instancat paraprake, për të cilat bën fjalë kjo kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, nuk përmbajnë gabime juridike. Avokati mbrojtës i referohet vetëm fjalive të përzgjedhura në mënyrë selektive duke i nxjerrë të njëjtat nga konteksti me qëllim të shfrytëzimit të tyre si argument. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se argumenti lidhur me mospërputhjen është i pabazuar.

19. Avokati mbrojtës deklaron se ka pasur kundërshti të mëdha në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë po ashtu rreth telefonatave në mes të [redacted] dhe [redacted]. Këto kundërshti e bëjnë aktgjykimin në fjalë të paqartë dhe të pakuptueshëm. Sipas avokatit mbrojtës, Gjykata Supreme e Kosovës ka pranuar ekzistimin e kësaj kundërshtie por përkundër kësaj ajo kishte ardhur në përfundimin se "... parregullsitë në fjalë në asnjë mënyrë nuk kanë keq orientuar gjykatën e shkallës së parë gjatë vlerësimit të fakteve dhe ...". Rrjedhimisht, nevoja për të ndryshuar arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë tregon qartë mbi faktin se një aktgjykim i tillë nuk është i qartë lidhur me faktet vendimtare të cilat çojnë gjer tek prishja apo anulimi i këtij aktgjykimi. Praktika e ndryshimeve formale është në kundërshtim me Nenin 403, par. 1, pikën 12, pasi që kjo dispozitë ligjore nuk përcakton një autorizim të tillë.

Gjatë adresimit të kësaj pike, Gjykata Supreme e Kosovës me gjithë respektin, ka një pikëpamje tjetër nga pikëpamja e avokatit mbrojtës. Në të vërtetë, Gjykata Supreme e Kosovës duke vendosur mbi ankesën në shkallën e dytë, ka bërë të ditur faktin që gjykata e shkallës së parë – gabimisht dhe në mënyrë të pasaktë ua ka ndërruar vendin emrave të të pandehurve [redacted]

BR VA VA VA

BR

Dokumentacioni në shkresat e lëndës, megjithatë, nuk lë hapësirë për dyshim lidhur me atë se kush kënd e ka thirrur. Këto biseda telefonike në mes të pandehurve dhe kurrë nuk janë kontestuar as nuk janë vënë në dyshim në asnjë fazë të gjyqimit. Kjo çështje del në pah vetëm pasi gjykata e shkallës së parë gabimisht ua ndërron vendin emrave në aktgjykim.

Inspektimi i shkresave të lëndës mundëson të konstatohet se edhe avokatët mbrojtës ashtu sikurse edhe trupi gjykues kanë pasur në posedim prova të mjaftueshme materiale për ta qartësuar këtë çështje. Kjo pikë nuk është kontestuese pasi që e njëjta mund të konstatohet në materialin e dokumentuar të shkresave të lëndës. Rrjedhimisht, nuk e ka atë nivel relevant saqë ta bëjë aktgjykimin të paqartë lidhur me faktet vendimtare. Referimi i Gjykatës së shkallës së parë, për këtë arsye, është më tepër një gabim i rëndomtë administrativ – i shtypit i cili është korrigjuar ashtu si duhet nga Gjykata Supreme e Kosovës gjatë procedurës së apelit. Me ligj nuk është e përcaktuar që për shkak të gabimeve drejtshkrimore, gjykata e apelit ta kthejë lëndën në rigjykim. Në fakt, një praktikë e tillë nuk do të mund të justifikohet; përkundrazi do të ishte në kundërshtim me parimet e ndryshme procedurale.

Për këtë arsye, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se kjo pikë është e pabazuar.

C. Shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës penale (Neni 396, par. 4, lidhur me Nenin 391, par. 1, pikën 1) / Nenin 451, par. (1) pikën 3) të KPPK-së)

20. Avokati mbrojtës deklaron në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë se dispozitivi i aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së parë nuk ofron përshkrimin e fakteve dhe të rrethanave për secilin të pandehur veç e veç, gjë e cila është e nevojshme për vlerësimin e ekzistimit të veprës penale, mënyrës së bashkëpunimit dhe për vlerësimin e dënimit. Edhe Gjykata Supreme e Kosovës ka shkelur Nenin 427, par. 1 të KPPK-së, gjithashtu duke shpërfillur këtë vlerësim. Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka vlerësuar veprimet e secilit të pandehur veç e veç por në përgjithësi dhe si pasojë kjo shkelje ka ndikuar në ligjshmërinë e aktgjyqimit.

Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se gjykatat e instancave paraprake në pjesën e arsytimit në mënyrë të saktë dhe të plotë kanë dhënë përshkrimin e hollësishëm të fakteve, të rrethanave dhe kontributin e secilit të pandehur gjatë kryerjes së veprës penale. Gjykatat në mënyrë të drejtë u referohen dispozitave të ligjit penal, duke qartësuar në këtë mënyrë formën e fajësisë të cilën e ka përcaktuar gjykata për secilin të pandehur veç e veç.

Për këtë arsye, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se kjo pikë është e pabazuar.

III. Përfundimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

Për arsyet e përmendura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton si më poshtë:

VA

NL

Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga avokati mbrojtës [redacted] në emër të të pandehurit [redacted] kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës P. Nr. 570/07, të datës 27 maj 2009 dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap 282/09, të datës 31 mars, janë të pabazuara.

Duke u nisur nga kjo, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PKL-KZZ 65/10, më 25 tetor 2011

Kryetari i kolegjit:

Martti Harsia
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtësi:

Adnan Isufi
Zyrtar ligjor

Anëtarët e kolegjit:

Salih Toplica
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Marije Ademi
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Erdogan Haxhibeqiri
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Anne Kerber
Gjyqtar i EULEX-it

Këshillë juridike: Nuk mund të ushtrohet kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ndaj vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilin është vendosur kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë (Neni 451, par. (2) i KPPK-së).